

Ditari Natyrës

**“Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENIOR-A
“Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze”**
Nr. 13 Viti i dytë i botimit Qershor 2014

Në këtë numër do të gjeni:

- Shërbimi Pyjor aftësohet të bashkëpunojë me median.
- Mision monitorimi për Ekomuzeumin e lumit Vjosa/Aoos.
- 10-11 Maj, Dita Botërore e Shpendëve Shtegëtarë.
- Inspektime mbi gjuetinë e paligjshme në Liqenin e Ulzës.
- Zhvillohet takimi i Dytë i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës.
- 22 Maji, Dita Botërore e Biodiversitetit.
- Njoftime.

Shërbimi Pyjor aftësohet të bashkëpunojë me median

Tiranë, 7 Maj 2014 - Vetëm dy muaj pas trajnimit të parë mbi zhvillimin e aftësive bazë të komunikimit, projekti WWF- Parqet Dinarike organizoi trajnimin e dytë të stafit të Shërbimit Pyjor me 23 specialistë dhe menaxherë nga 17 zona të mbrojtura të Shqipërisë. Kësaj here, në fokus të programit të

trajnitit ishin vendosur përgatitja e materialeve promovuese për secilin park si dhe bashkëpunimi i efektshëm me median lokale në shërbim të ruajtjes së trashëgimisë së zonave të mbrojtura.



Trajnimit dy-ditor, që u zhvillua në Tiranë në datat 7 dhe 8 Maj, ishte një modul praktik i ndërtimit të dialogut me Median dhe konceptimit të një fletëpalosje apo broshure informuese për turistët ose komunitetin. Ekspertët e WWF Mesdhe u prezantuan specialistëve të Shërbimit Pyjor metodat e grumbullimit të materialeve, teknikat e percjelljes së mesazhit në mbrojtje të parqeve dhe mënyrat më të efektshme të informimit publik në bashkëpunim me median lokale. Në përfundim të këtyre dy moduleve të trajnimit, menaxherët shqiptarë të zonave të mbrojtura janë në gjendje të organizojnë takime me me-

Vijon në faqe 2



Organizatrat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE CAJUPI
Bashkejeto me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



Vijon nga faqe 1 dian, të përgatisin një fletëpalosje me informacionin bazë apo udhëheqin grupe vizitorësh duke zbuluar për ta, pasuritë natyrore dhe trashëgiminë e çmuar që parku i tyre mban.

Një nga pjesëmarrësit në trajnim, Z. Pjeter Toni që punon për menaxhimin e rezervatit Kune-Vain-Tale në zonën e Lezhës theksoi - “Ky lloj trajnimi praktik në komunikim është shumë i vlefshëm për stafin që ka një profil te veçantë, si inxhinierë pyjesh apo biologë. Ata e shohin tani parkun nga një këndvështrim tjetër dhe kështu do të kenë rezultate më të mira në punën e përditshme me komunitetin, vizitorët apo median.”

Misioni monitorimi për Ekomuzeumin e lumit Vjosa/Aoos

Përmet, 07 Maj 2014 - Në kuadër të përfundimit të Projektit: **“Ekomuzeumi i Lumit Vjosa/Aoos, promovimi dhe mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të basenit të Lumit Vjosa/Aoos”** (VAEcoM), një Misioni monitorimi me përfaqësues nga Ministria e Integritetit u organizua pranë Pikënisjes së Ekomuzeumit në Qendrën Multifunksionale në qytetin e Përmetit. Projekti është bashkëfinancuar nga fondet e Bashkimit Europian dhe fondet kombëtare të Shqipërisë dhe Greqisë në kuadër të programit IPA ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2007-2013. Misioni monitorues



vizitoi nga afër Pikënisjen e Ekomuzeumit të Lumit Vjosa/Aoos i cili prej 25 Janarit 2014 i ka hapur dyert për të gjithë të interesuarit pranë Qendrës Multifunksionale të Bashkisë Përmet. Përfaqësuesit e Ministrisë së Integritetit patën mundësinë që përmes infrastrukurës së ekomuzeumit të vizitojnë një faqe interneti në tre gjuhë të ekomuzeumit www.ecomuseum.eu ku gjen një informacion të pasur mbi projektin dhe zonën që ai mbulon si dhe informacione orientuese mbi ekomuzeumin nëpërmjet një turi virtual, sëbashku me një guidë informuese mbi rrugët tematike në Shqipëri, Greqi dhe Anglisht. Misioni monitorues u takua me Kryetarin e Bashkisë Përmet Z. Gilber Jaçe si dhe

Muaji Qershor 2014 sjell një axhendë të ngarkuar për Parqet Dinarike të Shqipërisë. Përpos një konference në nivel kombëtar, ky muaj do të sjellë publikimin e një broshure përmbledhëse mbi destinacionet turistike në 15 parqet kombëtare të Shqipërisë në gjuhët shqipe dhe angleze, si dhe prezantimin e materialeve informuese për secilin park kombëtar. WWF Parqet Dinarike është një projekt i angazhuar me ruajtjen dhe promovimin e një rrjeti rajonal prej 80 parqesh kombëtare që zbatohet në Shqipëri nga WWF Mesdhe dhe INCA (Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri.)

me Zj. Ilda Nina punonjëse e bashkisë përgjegjëse për Qendrën e Informacionit Turistik të Bashkisë Përmet, pjesë e punës së të cilës do të jetë edhe

drejtimi dhe mirëmbajtja e Ekomuzeumit të Lumit Vjosa/Aoos në të ardhmen. Me pas Misioni organizoi një takim të ngushtë me stafin

e projektit për të analizuar të gjithë aktivitetet e kryera në kuadër të projektit VAEcoM si dhe vështirësitë e ndeshura gjatë zbatimit. Misioni u informua se një rrjet i përbashkët ndërkufitar i operatorëve lokal në Shqipëri dhe Greqi do të menaxhojë Ekomuzeumin në të ardhmen. Pjesë e këtij rrjeti janë edhe vetë partnerët e projektit në të dy vendet. Për rrejtin në Shqipëri është hartuar edhe firmosur edhe një memorandum i veçantë i cili ka përcaktuar strukturat dhe ka ndarë përgjegjësitë midis anetarëve. Rrjeti për Shqipërinë kryesohet nga Kryetari i Bashkisë Përmet dhe ka mbi 15 antarë.

Takimi u organizua në Zyrën e Kryetarit të Bashkisë Përmet i cili në përfundim të takimit shprehu konsideratën e tij për punën bashkëpunuese të kryer nga projekti, falenderimin për iniciativën e relizimit të kësaj nisme në Përmet duke sjellë një risi bashkëkohore në shërbim jo vetëm të promovimit të vlerave të paçmuara natyrore dhe kulturore të zonës, por edhe të zhvillimit të turizmit në zonë.

10-11 Maj, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Dita Botërore e Shpendëve Shtegtar ka filluar të festohet nga viti 2006 dhe ka si qëllim që të sjellë në vëmendjen e popullatës dhe të shërbejë si një ditë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e shpendëve migrator dhe habitatet e tyre. Kjo dite organizohet nga Sekretariati i Konventës për Ruajtjen e Specieve Migruese të Kafshëve të Egra (Konventa e Bonit) dhe Marrëveshja për Ruajtjen e Shpendëve Ujor Shtegtar Afrikanë-Euroziatik, dy marrëveshje ndërkombëtare për mbrojtjen e jetës së egër që administrohen nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP). Këtë vit fushata mbështetet nga Ministria Federale e Mjedisit të Gjermanisë. Këtë vit tema kryesore e Ditës është “Rrugët e migrimit: Zogjtë Shtegtar dhe Turizmi” (Destination Flyways: Migratory Birds and Tourism).

Në vendin tonë nuk ka anjsë traditë të festimit apo kujdesjes për shpendët shtegtarë dhe habitatet e tyre. Në 20 vitet e fundit ato janë cilësuar si “malli” i mundshëm për tu vlarë nga çdo njeri që mund të ketë një armë në dorë, bile është e quajtur një gjë normale. Gjendja e faunës së egër në vendin tonë pavarësisht mangësisë së të dhënave të detajuara dhe në shumë raste të disa shifrave “rozë” të Ministrisë së Mjedisit, sot është evident fakti i mungesës ose/ dhe pakësimit të llojeve autoktone të faunës së egër dhe përkeqësimi i gjëndjes së shpendëve migrator që kalojnë e ndalojnë në vendin tonë. Jo vetëm ky perceptim që lidhet (i) me mos praninë e shpendëve në sistemet ligatinore të vendit, (ii) “ankesave” të gjuetarëve profesionistë për mungesat e gjahut, (iii) zhdukjes tashmë të thellëzës së fushës dhe pakësimit të thellëzës së malit, por edhe nga ato pak të dhëna të monitorimit që japin një zvoglim prej 40-50% të sasisë së faunës së egër në vendin tonë në krahasim më 20 vite më parë. Shkaqet e përkeqësimit të gjëndjes janë cituar nga specialistët e fushës, dhe mund të listohen në:

- Ushtrimi i gjuetisë pa kriter gjatë gjithë sezonit, për më tepër në periudhat kur popullatat janë në kohën e riprodhimit;
- Ushtrimi i gjuetisë me metoda dhe mjete të ndaluara (kurthe dhe gjuetia me mjete imituese);
- Dëmtimi, varfërimi dhe degradimi i ekosistemeve dhe habitateve që shërbejnë për ushqimin, strehimin dhe folelizimin e faunës së egër;
- Rritja e vazhdueshme e pranisë së njeriut dhe bagëtive që ndikojnë në prishjen e qetësisë.

Në Shkurt 2014 Parlamenti Shqiptar, për kënaqësinë e organizatave mjedisore dhe pakënaqësinë e Federatës së Gjuetarëve dhe Agjensive Turistike që sjellin gjuetar Italian, aprovoi moratorimin e aktivitetit të gjuetisë për dy vjet në vendin tonë. Ky mund të quhet pa dyshim një nga vendimet më të forta të qeverisë së re, që duhet përshëndetur.

Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës, që përmbledh 8 organizata jo fitm prurëse, të drejtuar nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës (INCA) ka përshëndetur dhe ka mbështetur vendimin e marrë. Nga ana tjetër mendojme se këto dy vite duhet të shërbejnë për të përgatitur një infrastrukturë njerëzore dhe institucionale, por edhe ligjore që të rivendosë në vend kontrollin e aktivitetit të gjuetisë dhe normalizimin e gjëndjes për shpendët migratorë. Kjo do të shërbejë si një premisë e mirë për rritjen e turizmit që vlerëson ambjentet natyrore dhe prezencën e shpendëve si atraksion i veçantë.

Stafi teknik i Ministrisë së Mjedisit ka filluar të punojë por kërkohet me shumë intesitet dhe mbështetje, për të mos nxituar në marrjen e masave por nga ana tjetër për të mos qëndruar në vend.

Për këtë qëllim Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës propozon:

- Duhet të nisë sa më shpejt procesi i bllokimit të armëve,
- Monitorimi i zbatimit të ndalimit të gjuetisë në të gjithë territorin e vendit,
- Ngritja e një sistemi monitorimi të gjëndjes së faunës së egër dhe shpendëve shtegtar,
- Matrikullimi i trofeve të gjuetisë,

Vijon nga faqe 3

- Amendimi i ligjit të gjuetisë por edhe përgatitja e akteve nënligjore,
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve lokale.

Kjo ditë duhet të shërbejë për të bërë një thirrje të re

për ndryshimin e gjëndjes të faunës së egër në vendin tonë, jo vetëm për vlerën e biodiversitetit të vendit tonë por edhe si një burim për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në vendin tonë.

Inspektime mbi gjuetinë e paligjshme në liqenin e Ulzës

Ulzë, 10 Maj 2014 - Me mbështetjen e INCA-s dhe



REC Shqipëri, në zbatim të programit SENiORA me financim të qeverisë Suedeze, organizata

Miqësia Ulzë në bashkëpunim me Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit, përfaqësues të Pyjeve

komunal, përfaqësues të Komunës Ulzë, të Policisë së Rendit dhe Inspektoriatit të Peshkimit në rrethin e Matit, kanë kryer patrullime në liqenin e Ulzës për ndalimin e gjuetisë së paligjshme në këtë liqen dhe sidomos të asaj me lëndë plasëse.

Inspektimet do të vazhdojnë pa ndërprerje në të ardhmen në të mirë të mirë menaxhimit të gjuetisë së ligjshme të peshkut në këtë liqen dhe të mbarë komunitetit të zonës për ruajtjen e vlerave të Parkut Natyror Rajonal Ulzë,

Zhvillohet takimi i dytë i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës

Gjirokastrë, 21 Maj 2014 - U zhvillua në Gjirokastrë takimi i dytë i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës. Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e të gjithë përfaqësuesve të organizatave partnere të rrjetit (INCA, Mbrojtja e Mjedisit-Kukës, Iliria-Tiranë, Miqësia-Ulzë, Adriatik-Vlorë, Clean&Green-Korçë, Çajupi-Gjirokastrë). Ky takim kishte si qëllim kryesor diskutimin e aktiviteteve të organizatave të rrjetit për vitin 2014 dhe veçanërisht strategjinë e veprimit në rrjet për të rritur dukshmërinë e tij. Takimi sipas diskutimeve u nda në tri pjesë kryesore, në fillim diskutimi i ecurisë dhe aktivitetet për të ardhmen, vizibiliteti i rrjetit në aktivitet e çdo

organizate si dhe themelimin e bashkëpunimeve me organizatat lokale dhe pse jo edhe ndertimin e rrjetve lokale. Një

vend të rëndësishëm në takim zuri edhe diskutimi i çështjes së ndërtimit të faqeve zyrtare



web të organizatave gj gjë që do të rriste me shumë dukshmërinë e rrjetit dhe çdo organizate.

22 Maji, Dita Botërore e Biodiversitetit

Virua, 22 Maj 2014 - Kombet e Bashkuara e shpallën 22 Majin si Ditën Ndërkombëtare e Biodiversitetit për të rritur ndërgjegjësimin dhe përmirësuar vlerësimin e çështjeve të biodiversitetit. Kjo ditë u shpall për të kujtuar miratimin e tekstit të Konventës së Diversitetit Biologjik në 22 Maj 1992 nga Akti Final i Konferencës së Nairobit.

Edhe Shqipëria vitet e fundit i është bashkuar festimeve të kësaj dite ndërkombëtare duke organizuar aktivitete të ndryshme sensibilizuese me

fokus çështjet e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit në Shqipëri, vlera që janë vënë gjithmonë e më shumë në rrezik nga keqmenaxhimi dhe shfrytëzimi për përfitime.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit, organizata Çajupi, pjesë e “Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës”, në bashkëpunim me INCA-n (Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri) organizoi në Virua (Gjirokastrë) aktivitetin “Të mbrojmë dhe rehabilitojmë liqenin e Viroit”.

Vijon në faqe 5

Vijon nga faqe 4 Liqeni i Viroit është Monument Natyre që prej vitit 1982 vetëm 3 kilometra larg qytetit të Gjirokastrës. Një oaz i mikroklimës me ndikim të drejtpërdrejt në përmirësimin e parametrave klimatike të qytetit të Gjirokastrës. Një



liqen artificial me sipërfaqe ujore prej 17.5 hektarësh që ushqehet me ujrë që burojnë me vrull nga

“Mema”, një burim shumë i thellë, me natyrë karstike, me ujë të kulluar e të pastër. Mendohet se uji i Viroit vjen nga shpella me natyrë karstike e Skotinisë, që ndodhet në fshatin Vanistër në jug të Gjirokastrës. Kodrat përreth të mbështetura mbi shpatullat e Malit të Gjerë i japin kësaj zone hijeshi dhe peizazhe të papërsëritshme me vlera ekonomike e rekreative. Kodrat përreth Viroit janë pyllëzuar nga Ndërmarrja Pyjore në vitet 1972-1975 me llojin Pishë e egër dhe janë trajtuar si Pyll-Park. Mbas vitit 1991 shkatërrimi i pyllit dhe ekosistemeve në Virua është rezultat i një veprimtarie të pa kontrolluar, e cila ka sjellë

- Dëme të konsiderueshme vit pas viti të kurorës së gjelbër të liqenit dhe disa herë është rrezikuar nga zjarret dhe ajo pak bimësi e mbetur.
- Liqeni, nga një basen dikur për lundrimin me varka, për notin apo peshkimin sot është mbuluar

nga algat dhe bimësi ujore.

- Mbetje të konsiderueshme urbane janë depozituar në ekstremin lindor të tij, ngjitur me rrugën nacionale Gjirokastrë - Tepelenë.

- Si pasojë e mos thellimit dhe pastrimit, nga tejmbushja prej vitesh, ujërat e rrëmbyer të tij po rrëmbejnë tokë nga sheshi i parkimit të automjeteve duke iu afuar gjithnjë e më tepër rrugës nacionale.

Mungesa e vëmendjes ndaj tij e ka kthyer atë nga një pikë të vizitueshme e të shumë kërkuar, në një pikë turistike të braktisur.

Për këtë arsye duke vlerësuar këto realitete në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit, Shoqata Mjedisore “ÇAJUPI” dhe Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës, realizuan aktivitete sensibilizuese dhe promovuese për mbrojtjen dhe rehabilitimin e natyrës në liqenin e Viroit me pjesëmarrjen e grupeve të interesit nga shoqëria civile, Qarku, Prefektura, Bashkia e Qytetit, Universiteti “Eqrem Cabej”, Drejtoria Arsimore, Agjensia Rajonale e Mjedisit, DRSHP Gjirokastrë, etj.

Kjo inisiativë u ndërmor edhe për t’ju bashkuar nismave ndërkombëtare por njëkohësisht edhe tërheqjen e vëmendjes për problematikat vendore lidhur me mungesën e sensibilimit dhe keqmenaxhimin e burimeve ujore dhe pyjore në Shqipëri. Rrjeti i organizatave për ruajtjen e natyrës e sheh të nevojshëm lobimin për tërheqjen e vëmendjes së aktorëve lokal dhe kombëtar lidhur me këto çështje.

Vizitë pune e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës në Greqi

Janinë, 23 Maj 2014 - Pas zhvillimit të takimit të Rrjetit dhe aktivitetit në Gjirokastrë, Rrjeti u zhvendos në Janinë për të organizuar një takim me organizatat



partnere në Greqi por edhe për të shijuar bukuritë natyrore të basenit të Lumit Vjosë. Në këtë mënyrë Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës, ndërmori edhe një hap tjetër të rëndësishëm me prioritet ndërkombëtar,

atë të lëvizjes së OSHC kundër ndërtimit të hidrocentraleve në lumin Vjosë. Takimi u zhvillua në fshatin Vuvussa, ku Rrjeti realizoi një takim me përfaqësuesin e Administratës së Parkut Pindos, me Kryeplakun e fshatit dhe pjesëtarë të tjerë të



organizatave të shoqërisë civile, kryesisht Pindos Paravellis. Në diskutimet e lira doli në pah nevoja e koordinimit të

Vijon në faqe 6

Vijon nga faqe 5 punës midis organizatave të shoqërisë civile midis dy vendeve si edhe intesifikimi i punës për lobimit kundër ndërtimit të hidrocentraleve në zonë e lumit Vjosës në të dy shtetet. Ky takim pati si qëllim kryesor ndarjen e shqetësimit nga ana Shqipëtare lidhur me këtë çështje dhe diskutimi i pasojave që vuan zona ku tashmë janë ndërtuar këto hidrocentrale në anën



greke. Pala greke shprehu gadishmërinë e realizimit të një takimi dhe lobimi kundër kësaj çështje aktuale në Shqipëri me pjesëmarrjen e një grupi më të gjerë aktorësh shqiptar dhe grekë për të bashkuar zërin më fuqishëm kundër kësaj çështje.

NJOFTIME

- 1 - Mediterranean Initiative Bulletin is now online.
http://wwf.panda.org/what_we_do/where_we_work/mediterranean/mediterranean_initiative_bulletin/mibulletin_issue4/
- 2- IUCN _ Bulletin
https://cmsdata.iucn.org/downloads/iucn_see_e_bulletin_37_spring_2014_.pdf
- 3- Opportunities of Study in Japan
http://www.it.emb-japan.go.jp/italiano/albania/scholarship_2015.html
- 4 - Japanese Government
Scholarship for 2015 (Research student)
http://www.mext.go.jp/a_menu/koutou/ryugaku/boshu/1346643.htm

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

- Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org